



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr.2041/9 Prot

Tiranë, më 29.9.2023

VENDIM

Nr.44, datë 29.9.2023

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. _____, (në vijim “ankuesi”), ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 2041 prot., datë 06.07.2023, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik/Radio Televizioni Shqiptar/Këshilli Drejtues i Radio Televizionit Shqiptar (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, nëpërmjet kërkesës së datës 16.06.2023, ka kërkuar t’i vendoset në dispozicion dokumentacioni në lidhje me:

1. *Rregjistrimin audio dhe procesverbalin e mbledhjes së zhvilluar nga Këshilli Drejtues i R.T.SH., nga ku është vendosur skualifikimi nga gara i kërkuarit, shtetasit _____.*

Në mungesë të një përgjigje nga Autoriteti Publik, në përfundim të afatit ligjor, ankuesi i është drejtuar Zyrës së Komisionerit, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të kërkuar.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim, “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”*, Komisioneri nëpërmjet shkresës nr. 2041/1 prot., datë 11.07.2023, drejtuar Autoritetit Publik, ka kërkuar të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për informacion, si dhe sqarime për disponimin e dokumentacionit të kërkuar.

Autoriteti Publik, nëpërmjet shkresës nr. 1484/1 prot., datë 18.07.2023, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 2041/2 Prot., datë 19.07.2023, i ka deleguar trajtimin e praktikës Këshillit Drejtues në Radio Televizionin Shqiptar, i cili, sipas nenit 92, të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive”, rezulton organ drejtues i Radio Televizionit Shqiptar.

Këshilli Drejtues në Radio Televizionin Shqiptar, nëpërmjet shkresës nr. 86/1 prot., datë 20.07.2023, regjistruar pranë Komisionerit me nr. 2041/3 Prot., datë 24.07.2023, ka kthyer përgjigje duke cituar se: *“...Lidhur me informacionin që kërkohet, Këshilli Drejtues i RTSH-së ka njoftuar Kuvendin e Shqipërisë me shkresën nr. 79/1 prot., datë 29.06.2023... së fundmi ju bëjmë me dije se sipas Vendimit Nr. 98/2016 “Për miratimin e Statutit të Radio Televizionit Shqiptar”, miratuar në datë 22.12.2016, neni 11, pika 2, shpreh se: 2. Me mbarimin e afatit të aplikimit, Këshilli Drejtues bën vlerësimin e kandidatave të paraqitura në mbështetje të dokumentacionit të dorëzuar, verifikon dhe saktëson vërtetësinë e tyre dhe me votim të fshehtë, vendos përfshirjen e tyre në konkurim, duke i renditur sipas rendit alfabetik të mbiemirit... Votimi për garën është i fshehtë sipas ligjit...”*

Në këto kushte, me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të LDI, në të cilin citohet se: *“Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale... Kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”*, si edhe bazuar dhe në nenin 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, me shkresën nr. 2041/4 prot., datë 26.07.2023, Komisioneri ftoi palët në një seancë dëgjimore.

Koordinatorja për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik, me e-mail-in datë 13.09.2023, sqaroi se: *“... është e pamundur pjesëmarrja në seancën dëgjimore të planifikuar, pasi me anë të autorizimit nr. 990/3 prot, datë 08.09.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm jam ngarkuar dhe autorizuar për të përfaqësuar RTSH si palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor civil që do të zhvillohet ditën e sotme në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Gjithashtu ju bëj me dije se çështja e ngritur nga*

z. *nuk është ndjekur nga koordinatori por është trajtuar nga Këshilli Drejtues i RTSH-së”.*

Nisur edhe nga fakti se çështja objekt shqyrtimi është trajtuar nga Këshilli Drejtues në Radio Televizionin Shqiptar, seanca dëgjimore u zhvillua me datë 13.09.2023, me prezencën e përfaqësuesve të Këshillit Drejtues në Radio Televizionin Shqiptar dhe të përfaqësuesit të ankuesit, të cilët i qëndruan pretendimeve të trajtuara në shkresat e sipërcituara.

Në përfundim të seancës dëgjimore, Komisioneri i la afat përfaqësuesëve të Këshillit Drejtues në Radio Televizionin Shqiptar, për të përcjellë qëndrimin përfundimtar lidhur me këtë çështje brenda datës 15.09.2023.

Në vijim, Këshilli Drejtues në Radio Televizionin Shqiptar, me anë të shkresës me nr.86/5 prot., datë 15.09.2023, regjistruar pranë Komisionerit me nr. 2041/8 Prot., datë 18.09.2023, sqaroi se: *“...Në bazë të ligjit nr. 97, datë 04.03.2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, neni 104, pika b) “të jetë person i lidhur, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” ose që ka në pronësi pjesë kapitali apo aksione të shoqërive tregtare, si dhe të drejta të tjera në fushën e transmetimeve audiovizive, reklamës, prodhimeve të përmbajtjes së transmetimeve audiovizive, rrjeteve të komunikimit elektronik apo persona të punësuar gjatë vitit të fundit, anëtarë të organeve drejtuese apo këshilluese të këtyre subjekteve apo të lidhur me ndonjë licencë me këto subjekte.” Aplikanti për postin e Drejtorit të Përgjithshëm dhe jo vetëm ai është s’kualifikuar në fazën e parë të Konkurimit, në momentin e shqyrtimit të dokumentave. Në dosjen e tij nuk është përfshirë deklarata dhe vertetimi për dorëheqjen nga posti i Drejtorit të , ç’ka flet hapur për konflikt interesi. Ky është thelbi i çështjes i cili nuk ka të bëjë aspak me ç’farë është diskutuar në Këshillin Drejtues. Ç’farë do që të jetë diskutuar, nuk e ndryshon thelbin. Aq më shumë nuk mund të jepen shpjegime sepse gjithmonë sipas ligjit, votimi ka qënë i fshehtë...”.*

Bazuar në Rregulloren “Për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit Drejtues të RTSH-së”, neni 24 shprehet se: “Procerverbali i mbledhjeve u komunikohet sipas kërkesës së tyre të gjithë anëtarëve të Këshillit, si dhe organeve të autorizuar me ligj. Sipas Rregullores në RTSH, dokumentacioni i mbledhjes nuk mund t’i vihet në dispozicion ankuesit...”.

Në përfundim, pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se argumenti i paraqitur nga Autoriteti Publik për mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar, nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI, si dhe detyrimet që burojnë nga ky i fundit.

Gjatë gjithë procesit të hetimit administrativ të ankesës, Autoriteti Publik nuk provoi në asnjë moment, se në cilën pikë të nenit 17 të LDI e mbështet qëndrimin e tij lidhur me mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar, pasi është ky nen, i cili

parashikon mundësinë e kufizimit të të drejtës për informim, shkaqet dhe arsyet që mund të çojnë një autoritet publik për të kufizuar të drejtën për informim, si dhe rastet përjashtimore nga ky rregullim.

Në pikën 6 të këtij neni, parashikohet gjithashtu se: “...Autoriteti publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”. Bazuar në këtë parashikim, Autoriteti Publik duhet të kishte vlerësuar kërkesën për informacion, duke provuar dhe argumentuar mbi cilën pikë të nenit 17 bazohet kufizimi i informacionit, vlerësim ky i cili nuk rezulton të jetë bërë.

Për rrjedhojë, Autoriteti Publik nuk mund të bazojë kufizimin e një të drejte kushtetuese, vetëm mbi argumentin se: “Sipas Rregullores në RTSH, dokumentacioni i mbledhjes nuk mund t’i vihet në dispozicion ankuesit”.

Autoriteti Publik, në argumentat e vënë në dispozicion pas zhvillimit të seancës dëgjimore ka cituar si pengesë nenin 24 të rregullores “Për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit Drejtues të RTSH-së”, i cili parashikon se: “Procesverbali i mbledhjes së Këshillit Drejtues të RTSH duhet të përmbajë: 1. Një përmbledhje të gjithçkaje që u tha në mbledhje; 2. Data dhe vendi i mbledhjes; 3. Anëtarët që morën pjesë; 4. Çështjet që u diskutuan; 5. Vendimet që u morën; 6. Forma dhe rezultati i votimeve si dhe përcaktimi në mënyrë nominale i votave pro dhe kundër.

Procesverbali duhet tu paraqitet për miratim të gjithë anëtarëve që morën pjesë në mbledhje në fund të saj ose në fillim të mbledhjes pasardhëse. Pas miratimit nënshkruhet nga Kryetari.

Procesverbali i mbledhjeve të Këshillit ruhet në arkivën e RTSH, sipas rregullave dhe afatit të parashikuar në ligjin për arshivat.

Procesverbali i mbledhjeve u komunikohet sipas kërkesës së tyre të gjithë anëtarëve të Këshillit, si dhe organeve të autorizuara me ligj. Në rastet kur në mbledhje nuk merr pjesë Drejtori i përgjithshëm dhe/ose Kryetari i Bordit të Administrimit, këta të fundit kanë të drejtë të marrin informacionin rreth veprimtarisë së Këshillit.”

Në analizë të këtij neni, vërehet se në asnjë rast nuk parashikohet kufizimi për të vendosur në dispozicion të palëve të treta procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit Drejtues në RTSH. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, refuzimi i dhënies së informacionit mbi bazën e nenit 24 të rregullores, është i gabuar, pasi, sipas qëndrimit të mbajtur nga Këshilli Drejtues, aksesit në informacionin e disponuar nga ky autoritet publik i’u legjitimohet vetëm anëtarëve të Këshillit, si dhe organeve të autorizuara me ligj, duke përjashtuar a priori çdo individ që kërkon akses në informacion sipas dispozitave të LDI.

Megjithatë, Komisioneri thekson se rregullorja është një akt i brendshëm, akt ky i cili në asnjë moment nuk mund të prevalojë mbi Kushtetutën dhe LDI, si legjislacioni i posaçëm që rregullon këtë të drejtë.

Në shkronjën “a” të pikës 1, të nenit 2, të LDI parashikohet se: “Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të

krijuara me Kushtetutë ose me ligj”. Në kuptim të këtij parashikimi, Radio Televizioni Shqiptar, Këshilli Drejtues në Radio Televizionin Shqiptar, është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në nenin 1 përcakton se: *“1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. 2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. 3. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.”*

Për sa më sipër, bazuar edhe në shkresën nr. 86/5 prot., datë 15.09.2023, në të cilën pranohet se informacioni objekt shqyrtimi zotërohet nga Këshilli Drejtues në Radio Televizionin Shqiptar, Komisioneri vlerëson se, informacioni/dokumentacioni i kërkuar, përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të LDI, sipas të cilit *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*”.

Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit objekt shqyrtimi, ngarkon me përgjegjësi Autoritetin Publik, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar, duke mbajtur në konsideratë parashikimin sipas pikës 6, të nenit 17, të këtij ligji, ku përcaktohet se: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”*.

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të LDI, *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së z. _____, nr. 2041 prot., datë 06.07.2023, ndaj Autoritetit Publik, Radio Televizioni Shqiptar, Këshilli Drejtues i Radio Televizionit Shqiptar, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 16.06.2023, konkretisht: (“1. Rregjistrimin audio dhe procesverbalin e mbledhjes së zhvilluar nga Këshilli Drejtues i R.T.SH., nga ku është vendosur skualifikimi nga gara i kërkuesit, shtetasit _____.”), duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, brenda datës 06.10.2023.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 29.9.2023.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi